

Numri i lëndës: 2024:036257  
Datë: 25.03.2024  
Numri i dokumentit: 05497397

**C.nr.667/2024**

**GJYKATA THEMELORE GJILAN-DEGA V.**, gjyqtari Alush Sinani, me bashkëpunëtoren profesionale Dardana Behluli, në çështjen juridike kontestimore të paditëses F.M.nga V., e përfaqësuar nga G.R., avokat në V., kundër të paditurës Komuna V.-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi i shpenzimeve të ushqimit dhe të udhëtimit, vlera e kontestit 345.60 €, jashtë seancës, me datë 22.03.2024, mori këtë:

### **AKTGJYKIM**

**I.** Aprovohet e bazuar kërkesëpadia e paditëses F.M.nga V. dhe detyrohet e paditura Komuna e V.së-Drejtoria Komunale e Arsimit që paditëses, për 128 ditë të pranisë në punë, për periudhën nga data 22.01.2021 deri më 18.03.2022, t'ia paguajë shpenzimet e ushqimit në shumën 256 € dhe shpenzimet e udhëtimit në shumën 89.60 €, të gjitha në shumë të përgjithshme 345.60 €, me kamatë ligjore 8 %, e llogaritur nga dita e ngritjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit.

**II.** Detyrohet e paditura që paditëses t'ia paguajë shpenzimet e procedurës në shumën 99 €, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

### **Arsyetim**

Me datë 30.01.2024, përfaqësuesi i paditëses, në këtë gjykatë ka paraqitur padi kundër të paditurës, me objekt kontesti kompensimi i shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit, vlera e kontestit 345.60 €.

Në padi, ka theksuar se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura në ShFMU "Hysen Tërpeza" në fshatin Tërpezë, Komuna V. andaj, nga gjykata ka kërkuar që të detyrohet e paditura, që paditëses për 128 ditë të pranisë në punë, për periudhën nga data 22.01.2021 deri më 18.03.2022, t'ia paguajë shpenzimet e ushqimit në shumën 256 € dhe shpenzimet e udhëtimit në shumën 89.60 €, të gjitha në shumë të përgjithshme 345.60 €. Si prova, padisë i ka bashkëngjitur: Vërtetimin e lëshuar nga shkolla "Hysen Tërpeza", nr. 3/2, të dates 24.01.2024, Certifikatën e vendbanimit B 10331457, të datës 29.06.2021 dhe Vërtetimin nga kompanitë

transportueses që veprojnë në V.. Shpenzimet procedurale i ka kërkuar edhe atë shumë prej 21 € për taksën gjyqësore për padi dhe shumë prej 104 € për përpilimin e padisë.

E paditura, me përgjigje në padi, e ka kundërshtuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditëses, me pretendimin se nuk është përgjegjëse për detyrimet nga Kontrata Kolektive e V.t 2017 pasi pagat dhe mëditjet paguhen nga ministria përkatëse e poashtu, tutje ka pretenduar se Qeveria dhe Ministria e Arsimit e kanë shfuqizuar Kontratën Kolektive (tutje KK) të SBASHK-ut, nr. 105, të datës 22.01.2021 si dhe KK paraprake nr. 01B/2056, të datës 21.11.2022 prandaj edhe nuk rrjedh asnjë obligim për të paditurën ndaj paditëses. Lidhur me shpenzimet procedurale, nuk është deklaruar.

Gjykata ka gjetur se asnjë nga faktet e paraqitura në padi nuk janë kontestuese: ekzistimi i marrëdhënies së punës si dhe fakti se paditësja ka qenë e pranishme në punë 128 ditë dhe se gjatë kësaj periudhe kohore ka udhëtuar në relacionin V.-Tërpezë dhe anasjelltas, pasi e paditura nuk i ka kontestuar këto fakte.

Gjykata ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin është përcaktuar se: “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesë padinë” dhe ka ardhur në përfundim se të gjitha kushtet ligjore të përcaktuara në këtë nen janë plotësuar sepse, gjendja faktike nuk është kontestuese e po ashtu nuk ekzistojnë pengesa të tjera që pa caktuar seancë gjyqësore të pranohet si e themeltë kërkesëpadija e paditëses.

Sipas Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), përkatësisht nenit 245, paragrafit 1, është përcaktuar: “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë të përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”, lidhur me nenin 35, par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (tutje KKAK-së), të datës 18.04.2017 dhe KKAK-së të datës 22.01.2021, ku është përcaktuar se: “Të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim” dhe par. 5 të të njejtit nen, i cili përcakton se: “Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70 % të biletave të trafikut urban”, gjykata ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Kundërshtimet e të paditurës janë gjetur të pa bazuara sepse palët kontraktuese të KKAK-së, (Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK)), në nenin 2, par. 1.2., kanë përcaktuar: “Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”. Gjithashtu, neni 37 ka përcaktuar se: “Palët nënshkruese të kësaj kontrate kolektive janë të obliguara që të zbatojnë dhe t’i respektojnë dispozitat e kësaj kontrate”.

Vendimi për kamatën është bazuar në nenin 382 të LMD-së ndërsa, për shpenzimet e procedurës në nenin 452.1 lidhur me procedurat e kontesteve me vlerë të vogël, të përcaktuar në nenin 485.1 të LPK-së dhe numrin tarifor 6 nga Tarifa e Avokatëve të Kosovës, ashtu që gjykata ia ka pranuar shpenzimet paditëses në shumën 78 € për përpilimin e padisë dhe 21 € për taksën gjyqësore për padi, në shumë të përgjithshme 99 €.

Nga të lartcekurat, e duke u mbështetur edhe në nenin 142 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA V.**

**C.nr.667/2024, Datë 22.03.2024**

**Gjyqtari,**  
Alush Sinani

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në Gjykatën Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit. Ankesa në kopje të mjaftueshme, dorëzohet nëpërmjet kësaj gjykate.